



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1151/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Arben Mehmeti-anëtarë, me Ilire Mehmeti Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1151/2023 të datës 11.09.2023 të parashtruar nga ankuesi kundër organit të punësimit Ministria e Shëndetësisë në çështjen juridike "Kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 25.10.2023 mori këtë:

V E N D I M

HEDHET POSHTË si e palejuar ankesa me numër A.nr.1151/2023 e datës 11.09.2023 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ministria e Shëndetësisë në bazë të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, neni 39 (1,2 dhe 3) dhe nenin 52 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranim dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, fillimisht më datë 21.09.2022 ka njoftuar lidhur me shpalljen e konkursit me numër reference RN00009925 për Ngritje (avancim) në detyrë për pozitën e punës „Drejtor i Departamentit të Sistemit të Informacioneve Shëndetësore“ në Ministrinë e Shëndetësisë, me afat aplikimi nga data 06.10.2022 deri me date 14.10.2022.

Në bazë të listës së aplikacioneve në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesi të cilit sipas njoftimit për rezultatet e verifikimit paraprak nga Sistemit Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore më datë 26.10.2022 të njëjtit i është pranuar aplikacioni, dhe ka fituar të drejtën për të vazhduar procedurat e mëtejme të rekrutimit.

Më datë 07.07.2023 ankuesi ka parashtruar kërkesë me numër Nr.05-4144 për vazhdim të procesit të rekrutimit lidhur me konkursin me numër reference RN00009925, në Zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë.

Ankuesi më datë 11.09.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 6047/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke kërkuar vazhdimin e procesit të rekrutimit lidhur me Konkursin me numër reference Nr.RN00009925, me qëllim të zbatimit të dispozitave ligjore për ngritje në detyrë sipas nenit 34 paragrafi 4 dhe 9 si dhe nenit 39 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në pajtim me dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 22.08.2023, ka proceduar kërkesën e ankueses për përgjigje në ankesë në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtareve Publik. Ndërsa Këshilli më datë 23.08.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 6047/2023 të datës 11.09.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Dëshmi lidhur me fazën e verifikimit paraprak për ankuesin Dëshmi për rezultatet e verifikimit paraprak i datës 26.10.2023 për ankuesin Sh.N; Kërkesë për vazhdimin e rekrutimit me numër reference RN00009925 e datës 07.07.2023; Konkursi me numër reference RN00009925 i datës 06.10.2022; Lista e aplikantëve; Konkurs me numër reference RN00011722 i datës 23.06.2023; E-mail i datës 09.08.2023; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 13.09.2023; Përgjigje në ankesë e datës 13.09.2023; E-mail i datës 27.07.2023; E-mail i datës 10.07.2023; E-mailat e datës 07.07.2023.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa *ne* e ankuesit \_\_\_\_\_ është e palejuar, sepse:

Nga administrimi i provave materiale rrjedhë se Ministria e Shëndetësisë më datën 06.10.2022 ka shpallur konkursin me numër reference Nr. RN00009925 për ngritje (avancim) në detyrë, me titullin e punës „Drejtor i Departamentit të Sistemit të Informacioneve Shëndetësore“, Klasa e pozitës Drejtues i mesëm 1, ku në bazë të listës së aplikantëve në këtë konkurs kanë aplikuar tre (3) kandidatë dhe në mesin e tyre edhe ankuesi.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se Njësia e Burimeve Njerëzore pranë Ministrisë së Shëndetësisë nuk i ka përfunduar të gjitha procedurat e rekrutimit lidhur me konkursin me numër reference Nr. RN00009925 për ngritje (avancim) në detyrë ashtu siç e përcakton Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe Rregullorja (QRK) Nr.16/2020 për Pranim dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative sepse lidhur me kërkesën e datës 07.07.2023 të parashtruar në Zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Shëndetësisë edhe pse kanë kaluar gjashtëdhjetë e tri (63) ditë nga parashtrimi i saj ende nuk ka pranuar asnjë përgjigje lidhur me rastin e vazhdimin të procedurës së rekrutimit.

Ministria e Shëndetësisë përmes përgjigjes në ankesën e ankuesit konkretisht përmes dëshmimeve ofruara ka njoftuar Këshillin lidhur me procedurën në fjalë respektivisht ka njoftuar se kjo procedure nuk kishte përfunduar duke arsyetuar se procedura e rekrutimit gjegjësisht konkursi me numër reference Nr.RN00009925 i shpallur më datën 06.10.2022 për pozitën e punës „Drejtor i Departamentit të Sistemit të Informacioneve Shëndetësore“, ka ngecur në fazën e mbylljes së



konkurrimit dhe vlerësimit të aplikacioneve dhe nuk ka vazhduar tutje për shkak të dilemave lidhur me ndryshimet e Rregullores për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, ku janë ndryshuar edhe kriteret e përgjithshme formale.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 24 paragrafin 3 të Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publik konstaton se çdo nëpunës civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil sipas këtij ligji...". Ndërlidhur më këtë, neni 13 i Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ka përcaktuar se: "Përveç kur përjashtohet shprehimisht me ligj, secili person ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative dhe ato gjyqësore, në mënyrën e përcaktuar me ligj, kundër një veprimi apo mosveprimi administrativ të organit publik që i cenon një të drejtë që i është shkelur apo cenuar ndonjë e drejtë e tij nga marrëdhënia e punës me apo një interes juridik, ndërsa neni 125 paragrafi 1 i Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative përcakton se: "1. Përpos nëse është paraparë ndryshe me ligj, ankesa mund të parashtrohet kundër një akti administrativ apo ndaj mosveprimit të organit publik brenda afatit të përcaktuar për përfundimin e procedurës administrative (në vijim: heshtja administrative)" pastaj me dispozitat e nenit 127 paragrafi 4 i po këtij ligji ka përcaktuar se: "Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ". Përkatësisht sipas këtyre dispozitave ligjore rezulton se çdo nëpunës civil i cili pretendon një veprim administrativ (akt administrativ) apo mos veprim (heshtjes administrative) të organit gjegjes të punësimit, ka të drejtë të parashtrij ankesë drejtpërdrejt në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit ka analizuar edhe dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet afati për përfundimin e procedurës administrative përkatësisht neni 98 paragrafi 2 ku theksohet se: „ 2. Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj" andaj bazuar ne dispozitat e lartcekura si dhe në kuptim të pranueshmërisë së ankesës së ankuesit, Kolegji i Këshillit pasi ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të dërguara nga ana e organit të punësimit dhe ankuesi, nuk ka gjetur dëshmi se ankuesi ka parashtruar ankesë tek Ministria e Shëndetësisë apo në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës lidhur me mos vazhdimin apo përfundimin e procedurës së rekrutimit në fjalë deri më date 07.07.2023 kur ka parashtruar kërkesë në Zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Shëndetësisë edhe përkundër se e njëjta nuk e ka përfunduar procedurën e rekrutimit sipas dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, e që nënkupton që kjo kërkesë është paraqitur jashtë afatit ligjor, pasi që ankuesi këtë kërkesë ka pasur të drejtë ta parashtrij para (9)muajve. Kështu që në vlerësim të Kolegjit ankesa e ankuesit e datës 11.09.2023 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës sipas numrit të protokollit 6047/2023 është e parashtruar jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 127 paragrafit 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se : "Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data kur është njoftuar për aktin administrativ", si dhe neni 127 paragrafit 4 me të cilin parashihet se: 4. Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ", rrjedhimisht Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka vlerësuar se ankuesi nuk e ka shfrytëzuar të drejtën e ankimit brenda afateve ligjore sipas dispozitave të lartpërmendura në

Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës. Prandaj në kuptim të kësaj dhe nenit 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ankesa e ankuesit Shkëlzen Nuza është e pa lejuar.

Andaj, duke u bazuar në nenin 129 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

*Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
*Lënda me numër A.nr.1151/2023*

**Ilire Mehemti Shaqiri**

*Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional*

**Malsore GASHI BAJRAKTARI**

*Kryetare e Kolegjit*



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Njësisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Shëndetësisë; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

